



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

---

*Ex officio*

Rasti Nr.44/2017

## RAPORT ME REKOMANDIME

### I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

*në lidhje me*

*Zvarritjet procedurale në trajtimin e lëndëve nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme*

Drejtuar:

Z. Isa Mustafa, Kryeministër  
Qeveria e Republikës së Kosovës

Z. Nehat Idrizi  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Z. Sahit Sylejmani  
Kryetar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme

Prishtinë, më 31 janar 2017

## Qëllimi i raportit

1. Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së autoriteteve përkatëse shtetërore lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut të shkaktuara nga zvarritjet procedurale në trajtimin e lëndëve nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (Dhoma e Posaçme) dhe paraqitja e rekomandimeve për mënjanimin e këtyre shkeljeve.

## Kompetencat dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit

2. Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Kushtetuta), neni 135, paragrafi 3: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
3. Bazuar në nenin 16, paragrafi 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit: *“mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave.”*
4. Bazuar në nenin 18, paragrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka përgjegjësi: *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandime që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”*
5. Bazuar në nenin 18, paragrafi 1.7 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka përgjegjësi: *“të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen e apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.”*

## Përshkrimi i rastit

6. Ky raport është bazuar në 49 (dyzetënëntë) ankesa të ndara, aktualisht të hapura pranë Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e trajtimit të rasteve nga Dhoma e Posaçme, duke mos llogaritur këtu edhe ankesat e paraqitura kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e që lidhen me çështjet që kanë të bëjnë me Dhomën e Posaçme dhe që për nga natyra janë të njëjta me ankesat kundër Dhomës së Posaçme, pasi që edhe këto ankesa varen nga vendimet përfundimtare nga Dhoma e Posaçme. Ankesat e regjistruara në IAP datojnë që nga viti 2012, lista e të cilave është bashkëngjitur si aneks i këtij Raporti me Rekomandime.
7. Duhet pasur parasysh se përveç zvarritjeve nga Dhoma e Posaçme, rastet e ankuesve paraprakisht kanë kaluar edhe nëpër një procedurë pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit, gjë që ndikon akoma më shumë në zvarritjen zgjidhjes së këtyre ankesave.

## Veprimet e Avokatit të Popullit, bashkëpunimi dhe qëndrimet e Dhomës së Posaçme

8. Avokati i Popullit, pas pranimit të ankesave në pajtim me procedurat për pranimin dhe hetimin e ankesave i është drejtuar Dhomës së Posaçme lidhur me pretendimet nga ankesat e paraqitura, për secilin ankesë individualisht dhe në pothuajse të gjitha kërkesat e Avokatit të Popullit të drejtuara Dhomës së Posaçme ka pranuar përgjigje.
9. Në pothuajse të gjitha përgjigjet e pranuar nga Dhoma e Posaçme, Avokati i Popullit është njoftuar se një numër lëndësh që presin të gjykohen janë prolonguar në procedurat e Dhomës së Posaçme.

10. Në fillim të muajit dhjetor të vitit 2016, Avokati i Popullit është takuar me kryetarin e Dhomës së Posaçme nga i cili është njoftuar lidhur me sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet Dhoma e Posaçme. Kryetari i Dhomës së Posaçme ka pranuar se ka zvarritje në procedimin lëndëve dhe ka njoftuar se deri më 18 nëntor 2016 kanë mbetur të pakryera 21.640 lëndë në të dy shkallët e Dhomës së Posaçme, duke theksuar se mesatarja e ngarkesës më lëndë për një gjyqtar në Dhomën e Posaçme në shkallën e parë është rreth 1390 lëndë ndërsa në shkallën e dytë 130 lëndë. Kryetari i Dhomës së Posaçme më tej ka theksuar se Dhoma e Posaçme vazhdimisht ka ndjerë mungesën e këshilltarëve ligjor si dhe të përkthyesve duke theksuar se janë rreth 30.000 faqe dokumente që presin për përkthim e që janë të domosdoshme për procedimin e rasteve.
11. Avokati i Popullit vëren se Kryetari i Dhomës së Posaçme ka përgatitur një Raport për Këshillin Gjyqësor të Kosovës *Mbi gjendjen, vështirësitë dhe problemet si dhe masat duhet ndërmarrë për të zgjidhur problemet në Dhomën e Posaçme*. Sipas pohimeve të Kryetarit të Dhomës së Posaçme ai edhe në të kaluarën ka njoftuar autoritetet përkatëse për gjendjen në Dhomën e Posaçme dhe ka kërkuar ndërmarrje të masave për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara, por deri më tani nuk ka ndonjë zhvillim pozitiv lidhur me kërkesat e paraqitura.

**Ligji nr. 04/L-033 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

12. Funksionimi i Dhomës së Posaçme rregullohet me Ligjin nr. 04/L-033 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji). Sipas nenit 3, paragrafi 1 të Ligjit:  
*“Dhoma e Posaçme do të përbëhet nga një numër i gjyqtarëve deri në njëzet (20), dymbëdhjetë (12) prej të cilëve do të jenë shtetas të Kosovës, derisa tetë (8) do të jenë gjyqtarë ndërkombëtarë. Së paku dy (2) nga gjyqtarët që janë shtetas të Kosovës do të jenë nga komunitetet pakicë.”*
13. Duket që kjo dispozitë kufizon numrin e gjyqtarëve të Dhomës së Posaçme dhe se ky numër ishte paraparë në vitin 2002, kur me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13 është themeluar Dhoma e Posaçme për shqyrtimin e kontesteve nga procesi i privatizimit.

**Konstatimet e Avokatit të Popullit**

14. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen e autoriteteve shtetërore të neni 22 (2) i Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, në veçanti sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e saj (KEDNJ), e cila sipas këtij neni është drejtpërdrejtë e zbatueshme në Kosovë dhe ka prioritet në rast konflikti ndaj dispozitave dhe akteve tjera të institucioneve publike.
15. Avokati i Popullit po ashtu tërheq vëmendjen e autoriteteve edhe të neni 53 i Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.
16. Rrjedhimisht, vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit, lidhur me çështjen bazohen në Kushtetutë, KEDNJ, dhe praktikën e GJEDNJ-së

17. Avokati i Popullit duke u bazuar në përgjigjet e pranuar nga Dhoma e Posaçme, për rastet individuale si dhe nga vet pohimet e Kryetarit të Dhomës së Posaçme, konsideron se në përgjithësi kemi të bëjmë me zvarritje procedurale. Për shkak të një numri të konsiderueshëm të ankesave të cilat IAP i ka pranuar, Avokati i Popullit do të vlerësoj situatën në kontekstin sistematik. Kjo për shkak se për të vlerësuar nëse ka pasur shkelje në secilin rast individual duhet të bëhet një vlerësim sipas kritereve të vendosura nga GJEDNJ që përfshinë kompleksitetin e rastit, sjelljen e paditësit dhe sjelljen e autoriteteve shtetërore.
18. Në bazë të përgjigjeve që Avokati i Popullit ka pranuar nga Dhoma e Posaçme duket qartë se kemi të bëjmë me lëndë të grumbulluara dhe se një situatë e tillë është bërë e zakonshme për Dhomën e Posaçme që duket se është rezultat i numrit të kufizuar me ligj të gjyqtarëve, zëvendësimit e shpeshtë të gjyqtarëve, në veçanti gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe mungesës së këshilltarëve ligjor dhe përkthyesve. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se në rend të parë kemi të bëjmë me sjelljen e autoriteteve shtetërore karshi situatës në Dhomën e Posaçme.
19. KEDNJ përcakton obligimin e shteteve në organizimin sistemeve të tyre të drejtësisë, në mënyrë që gjykatat të përmbushin obligimin për të shqyrtuar rastet brenda afatit të arsyeshëm, pa marrë parasysh shpenzimeve që mund të shkaktohen me këtë organizim. Përndryshe, shtetet do të mbahen përgjegjëse jo vetëm për zvarritjet në zgjidhjen e ndonjë rasti të veçantë por edhe për dështimin për të ngritur resurset për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara dhe mungesat strukturale në sistemin e drejtësisë që shkaktojnë zvarritje të tilla.
20. Kur bëhet fjalë për rastet e grumbulluara që presin të shqyrtohen, GJEDNJ dallon situatat kur kemi të bëjmë me rastet e grumbulluara për një kohë të caktuar, ku shteti mund të mos mbahet përgjegjës nëse me kohë ka ndërmarrë veprime të duhura për përmirësim të situatës dhe rastet e grumbulluara në mënyrë të vazhdueshme për të cilat shteti mbahet përgjegjës. Autoritetet përkatëse, me gjithë kërkesat nga Kryetari i Dhomës së Posaçme dhe ankesat e shumta të qytetarëve që janë palë në procedurë pranë Dhomës së Posaçme, duket se nuk kanë ndërmarrë veprime për përmirësim të situatës sa i përket zgjidhjes se rasteve të grumbulluara.
21. Sipas praktikës së GJEDNJ është obligim i shteteve që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të garantojnë të drejtën për marrjen e një vendimi përfundimtar për secilin qytetarë lidhur me të drejtat dhe obligimet civile të tij, brenda një afati të arsyeshëm kohor (*Scordino kundër Italisë (no.1)*, § 183), ku ngarkesa e tepërt me lëndë nuk mund të merret në konsideratë (*Vocaturò kundër Italisë*, § 17; *Cappello kundër Italisë*, § 17). Në rast se zvarritja në vendosjen e rasteve është çështje e organizimit strukturor shteti duhet të sigurojë miratimin e masave efikase për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara (*Zimmermann dhe Steiner kundër Sëitserland*, § 29; *Guincho v. Portugal*, § 40). Fakti se grumbullimi i rasteve është bërë i zakonshëm nuk arsyeton zvarritjet e jashtëzakonshme të procedurave (*Unión Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës*, § 40).
22. Marrja e masave nga autoritetet përkatëse të Republikës së Kosovës, konkretisht ndryshimi i Ligjit për Dhomën e Posaçme, përkatësisht i dispozitës ligjore që kufizon numrin e gjyqtarëve në Dhomën e Posaçme, është një masë urgjente në rritjen e efikasitetit të Dhomës së Posaçme. Ndërsa si masë afatgjate e qëndrueshme dhe e

domosdoshme në funksionimin efikas të gjykatave në përgjithësi, të cilat janë të obliguara që të marrin një vendim brenda një afati të arsyeshëm, sipas kërkesave që dalin nga Kushtetuta, KEDNJ dhe praktika e GJEDN-së, është miratimi i një ligji që përcakton afate për zgjidhjen e rasteve gjyqësore si dhe kompensimin e palëve kur konstatohet se ka pasur zvarritje të procedurave gjyqësore. Mungesa e një ligji të tillë që parasheh afate dhe kompensime për zvarritje të jashtëzakonshme të procedurave drejtpërsëdrejti ndikon edhe në të drejtën për mjete efektive juridike, e drejtë kjo që po ashtu garantohet me Kushtetutë dhe KEDNJ.

23. Avokati i Popullit konsideron se zvarritjet procedurale pranë Dhomës së Posaçme, mund të kenë shkaktuar shkelje të së drejtës në një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] si dhe të drejtës për mjete efektive juridike, neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore të Drejtave] me të cilin parashihet e drejta në mjete efektive ligjore, të Kushtetutës.
24. E drejta që një çështje të dëgjohet drejtësisht brenda një afati të arsyeshëm parashihet edhe me nenin 6 të KEDNJ-së [E drejta në një proces të rregullt], ndërsa e drejta në mjete efektive juridike parashihet me nenin 13 të KEDNJ-së [E drejta për zgjidhje efektive].
25. Neni 6 dhe neni 13 i KEDNJ-së janë dy të drejta të ndara por që në raste të caktuara ndërlihen me njëra tjetrën. GJEDNJ në rastin *Kudla kundër Polonisë*, § 160, ka gjetur shkelje të nenit 6 dhe nenit 13 të KEDNJ-së për shkakun se paraqitësi i kërkesës nuk ka pasur mjete juridike të brendshme me të cilat atij do ti bëhej e mundur zbatimi i të drejtës “për gjykim brenda një afati të arsyeshëm” të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së. Situatë e njëjtë është edhe në rastin e palëve të cilët presin me vite për zgjidhje të lëndëve, ndërsa nuk kanë ndonjë mjet efektiv juridik për zbatimin e të drejtës së tyre në një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Në bazë të kësaj që u tha më lart, si dhe duke u nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë dhe me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së efikasitetit të autoriteteve, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 16, paragrafi 8, nenit 18, paragrafi 1.2 dhe nenit 18, paragrafi 1.7 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019.:

### Rekomandon që

1. *Qeveria e Kosovës, në bazë të rregullave dhe procedurave për nisma legislative, të propozojë ndryshimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përkatësisht nenin 3.1 të Ligjit në mënyrë që të ofrohet qasje e drejtë dhe efektive për palët në procedurë pranë Dhomës së Posaçme.*
2. *Këshilli Gjyqësor i Kosovës të ofrojë mbështetje Dhomës së Posaçme në aspektin organizativ dhe operativ në pajtim me kërkesat dhe nevojat e funksionimit adekuat të Dhomës së Posaçme.*
3. *Dhoma e Posaçme të hartojë një strategji për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara duke vendosur jo vetëm shpërndarje të barabartë të rasteve për*

*secilin gjyqtar, por edhe norma dhe afate brenda të cilave duhet të zgjidhet numër i caktuar i lëndëve nga secili gjyqtar.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerri si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, Ju lutem që përgjigjen tuaj, lidhur me këtë çështje, ta dërgoni brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se deri më **3 mars 2017**.

Me nderime,

  
Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Aneks:

Ankesat e regjistruara në Institucionin e Avokatit të Popullit

## Ankesat e regjistruara në Institucionin e Avokatit të Popullit

### Aneks

- |     |          |     |          |
|-----|----------|-----|----------|
| 1.  | 17/2017  | 31. | 642/2015 |
| 2.  | 943/2016 | 32. | 605/2015 |
| 3.  | 939/2016 | 33. | 601/2015 |
| 4.  | 926/2016 | 34. | 570/2015 |
| 5.  | 881/2016 | 35. | 563/2015 |
| 6.  | 745/2016 | 36. | 504/2015 |
| 7.  | 731/2016 | 37. | 470/2015 |
| 8.  | 725/2016 | 38. | 463/2015 |
| 9.  | 677/2016 | 39. | 449/2015 |
| 10. | 669/2016 | 40. | 435/2015 |
| 11. | 664/2016 | 41. | 222/2015 |
| 12. | 663/2016 | 42. | 81/2015  |
| 13. | 661/2016 | 43. | 68/2015  |
| 14. | 598/2016 | 44. | 387/2014 |
| 15. | 595/2016 | 45. | 386/2014 |
| 16. | 582/2016 | 46. | 38/2014  |
| 17. | 538/2016 | 47. | 568/2013 |
| 18. | 460/2016 | 48. | 284/2013 |
| 19. | 417/2016 | 49. | 312/2012 |
| 20. | 370/2016 |     |          |
| 21. | 350/2016 |     |          |
| 22. | 338/2016 |     |          |
| 23. | 294/2016 |     |          |
| 24. | 290/2016 |     |          |
| 25. | 200/2016 |     |          |
| 26. | 76/2016  |     |          |
| 27. | 44/2016  |     |          |
| 28. | 9/2016   |     |          |
| 29. | 698/2015 |     |          |
| 30. | 661/2015 |     |          |